

3189/

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR            VENDIMIT

**V E N D I M**  
**" PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK "**

Ne Tirane, sot date 08-07-2004 une gjyqtare e gjykates se shkalles se pare Tirane Arieme Coco.....mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur per regjistrimin si person juridik te " UNIVERS REKLAMA " SHPK

**K O N S T A T O V A**

Se ka themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " UNIVERSI BLU " shpk . Kjo shoqeri eshte themeluar nga ortaku i vetem Flamur Salija . Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Administrator I shoqerise eshte ortaku I vetem FLAMUR SALIJA . Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet . Selia e shoqerise eshte ne Tirane Unaza e Re Godina Astir .

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte :  
Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice, te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektoral, ushqimor,elektroshtepiake.Prodhim, tregtim dhe eksport te reklamave . Transport mallrash .

Kerkesa e kerkuesit gjendet e drejte dhe e bazuar dhe si e tille duhet te pranohet.

**P E R   K E T O   A R S Y E**

Bazuar ne ligjin nr 7667 date 28.01.1993 per "Regjistrin Tregetar" dhe ne ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare "

**V E N D O S A**

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "UNIVERS REKLAMA " SHPK Tirane .

- Emertimi i shoqerise eshte "UNIVERS REKLAMA " SHPK
- Ortak i vetem i shoqerise eshte Z FLAMUR SALIJA .
- Administrator I shoqerise ortaku I vetem FLAMUR SALIJA .
- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke ( njeqindmije) .
- Selia e shoqerise eshte ne Tirane Unaza e Re godina Astir .
- Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :  
Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice, te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektoral, ushqimor,elektroshtepiake.Prodhim, tregtim dhe eksport te reklamave . Transport mallrash .

Gjyqtare

*Arieme Coco*  
*A. G. 10/04*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE  
Nr. 318P/14 Vendimit.

V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne qytetin e Tiranes, sot ne daten 17.10 2005 ( dymije e pese), une Gjyqtaria e Shkalles Pare Tirane [Signature], mbasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i Shoqerise „Univers Reklama“ Sh.P.K. Z.Flamur Salija, duke marre ne analize kerkesat e ligjit Nr.7667 date 28 Janar 1993, si dhe duke patur parasysh nenet perkatese te statutit te shoqerise,

K O N S T A T O V A S E :

Me vendimin Nr.31891 date 08.07.2004 te Gjykates Shkalles Pare Tirane eshte krijuar Shoqeria „Univers Reklama“ Sh.P.K., me ortak te vetem dhe administrator Z.Flamur Salija, me kapital fillestar ne shumen 100.000 leke, me seli ne unazen e re godina „ASTIR“, me kohe zgjatje 10 vjet, me objekt : Import, eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektorak, ushqimor, elektroshtepijak. Prodhim, tregetim dhe eksport te reklamave. Transport mallrash.

Ortaku i vetem Z.Flamur Salija, duke marre ne analize kerkesat e ligjit Nr.7667 date 28 Janar 1993, si dhe duke patur parasysh nenet perkatese te statutit te shoqerise,

V E N D O S I :

1) T'i shese Beqir Nuredinit 50% te kuotave dhe te kapitalit te shoqerise “UNIVERS REKLAMA” Sh.P.K.

2)Administrator i shoqerise do te jete Flamur Salija.

3)Ortaku Beqir Nuredini do te fitoje te drejtat dhe detyrimet ne momentin qe do te nenshkruset kontrata perfundimtare e shitjes. Te gjitha detyrimet qe ka shoqeria perpara dates se nenshkrimimit te kontrates shitjes kuotave jane ne ngarkim te shitesit Flamur Salija.

4)Depozitimim prane Zyres se Regjistrimit Tregtar, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per te pasqyruar ndryshimet perkatese ne Statut dhe ne kolonen e regjistrimit tregtar.

Kerkesa qe keto ndryshime te reflektohen edhe ne skeden e kesaj shoqerice eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE VENDOSA**

**Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 per regjistrin tregetar**


V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses se administratorit te shoqerise Z.Flamur SALIJA, per depozitimin e vendimit te tij Nr.1 date 29.06. 2005.

Shoqeria perbehet nga dy ortakë Flamur Salija dhe Nuredin Bushi, te cilet kane nga 50% sejcili te kuptave dhe te kapitalit te shoqerise. Admonostrator i saj eshte Z.Flamur Saliaj.

Depozitimin e kerkeses dhe dokumentacionit te paraqitur nga Shoqeria „Univers Reklama „ Sh.P.K. Tirane duke bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kolonen 2, pika b,4 dhe 5, me Nr. rendor \_\_\_\_ te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
Nr. 31891/Vendimit.



V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne qytetin e Tiranes, sot ne daten 17.10.2005 (dytite),  
pese), une Gjyqtaria e Shkalles Pare Tirane  
shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i Shoqerise „Univers Reklama“  
Sh.P.K. Z.Flamur Salija, duke marre ne analize kerkesat e ligjit Nr.7667 date 28 Janar  
1993, si dhe duke patur parasysh nenet perkatese te statutit te shoqerise,

K O N S T A T O V A S E :

Me vendimin Nr.31891 date 08.07.2004 te Gjykates Shkalles Pare  
Tirane eshte krijuar Shoqeria „Univers Reklama“ Sh.P.K., me ortak te vetem dhe  
administrator Z.Flamur Salija, me kapital fillestar ne shumen 100.000 leke, me seli ne  
unazen e re godina „ASTIR“, me kohe zgjatje 10 vjet, me objekt : Import, eksport  
dhe tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor,  
blektorak, ushqimor, elektroshtepijak. Prodhim, tregetim dhe eksport te reklamave.  
Transport mallrash.

Ortaku i vetem Z.Flamur Salija, duke marre ne analize kerkesat e ligjit Nr.7667  
date 28 Janar 1993, si dhe duke patur parasysh nenet perkatese te statutit te shoqerise,

V E N D O S I :

- 1) T'i shese Beqir Nuredinit 50% te kuotave dhe te kapitalit te shoqerise  
„UNIVERS REKLAMA“ Sh.P.K.
- 2) Administrator i shoqerise do te jete Flamur Salija.
- 3) Ortaku ~~do te jete~~ do te fitoje te drejtat dhe detyrimet ne momentin qe  
do te nenshkruhet kontrata perfundimtare e shitjes. Te gjitha detyrimet qe ka  
shoqeria perpara dates se nenshkrimit te kontrates shitjes kuotave jane ne  
ngarkim te shitesit Flamur Salija.
- 4) Depozitimim prane Zyres se Regjistrimit Tregtar, te Gjykates se Shkalles se  
Pare Tirane, per te pasqyruar ndryshimet perkatese ne Statut dhe ne kolonen e  
regjistrimit tregtar.

Kerkesa qe keto ndryshime te reflektohen edhe ne skeden e kesaj shoqerie  
eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE VENDOSA

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 per regjistrimin tregtar




V E N D E S A

Praniman e kerkeses se administratave te shoqerise Z.Flamur SALJA, per depozitim e vendimit te tij Nr.1 date 29.06.2009.

Shoqeria perbehet nga dy ortakë Flamur Salijs dhe Nuredin Bushi, te cilet kane nga 50% sejcili te kuptave dhe te kapitalit te shoqerise. Admonstrator i saj eshte Z.Flamur Salijs.

Depozitimin e kerkeses dhe dokumentacionit te paraqitur nga Shoqeria "Univers Reklama" Sh.P.K. Tirane duke bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrit ne kolonen 2, pika b,4 dhe 5, me Nr. rendor \_\_\_\_\_ te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE



V E N D I M  
I  
GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 15. 03. 2007 (dymije e shtate), une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane M. Mushi, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentacionin bashkengjitur e paraqitur nga Shoqëria "UNIVERS REKLAMA" shpk., e përfaqësuar nga Administratori i shoqerise Z. Flamur SALIJA,

KONSTATOVA:

Shoqëria "UNIVERS REKLAMA" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31891, date 08.07.2004.

Ne Vendimin e Ortakut te Vetem te shoqerise te dates 29 qershor 2005, paraqitur kesaj Gjykate , Shoqëria ka kerkuar shitjen e 50% te kuotave te shoqerise dhe emertimi i te dy ortakëve eshte shenuar saktesisht Flamur Salija dhe Beqir Nuredini.

Ndersa ne vendimin e Gjyqtarit te Vetem te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne paragrafin e dyte te dispozitivit te vendimit eshte shenuar emri Nuredin Bushi kur ne te vertete emri i sakte i ortakut tjetër te shoqerise eshte Beqir NUREDINI.

Ne nenin 17 te ligjit 7667, date 28.01.1993 citohet "Gabimet e shtypit dhe gabimet e dukshme te ketij lloji, te bera gjate nje regjistrimi, korigjohen sipas vendimit te gjyqtarit ne ane te ketij regjistrimi, ne kolonen 5 me titull "Shenime"...

Ne keto rrethana administratori i Shoqerise i ben kerkese Gjykates se e Rrethit Gjyqesor Tirane, te beje korigjimin e gabimit te shtypit ne emertimin e Shoqerise nga Nuredin Bushi ne **BEQIR NUREDINI**.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj,

PER KETO ARSYE:

Ne mbeshtetje te nenit 17 te ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar".


V E N D O S A:

Pranimin e Kerkeses.

Depozitimimin e kerkeses per korigjimin e gabimit te shtypit ne vendimin e Regjistrimit te Personit Juridik te emertimit te Shoqerise nga Nuredin Bushi ne **BEQIR NUREDINI**.

Depozitimimin e kerkeses dhe dokumentacionit bashkengjitur nga Shoqëria duke bere ndryshimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kolonen 5 me titullin "Shenime".

Ky vendim mund te apelohet.

GJYQTARE  




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr. 31 88/3 Vendimi

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane, sot me date 18 (7) 2007 (dy mije e shtate), une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Majlinda Dogga, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z.Flamur Salija, ne cilesine e administratorit te Shoqerise Tregtare "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k., duke marre ne analize nenet perkatese te statutit te shoqerise dhe ne konformitet me dispozitat e Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare",

**KONSTATOVA SE:**

Shoqeria Tregtare "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik ne baze te Vendimit te Gjykates se rrethit Tirane Nr.31891\_, date 08.07.2004. Selia e kesaj shoqerie eshte ne Tirane, Unaza e Re, Godina e Astir.

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k. te dates 15.06.2007, eshte vendosur:

- I. Ndryshimi i selise se Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k., e cila nga adresa e vjeter: Unaza e Re, Godina Astir, do te jete ne adresen: **Qafa e Kasharit, tek mbikalimi i Rinasit.**
- II. Te rritet kapitali i shoqerise sipas raportit qe do te jape eksperti kontabel.
- III. Emerimin e ekspertit qe do te percaktoje sasine e rritjes se kapitalit dhe do te pergatise raportin perkates. Ne cilesine e ekspertit do te jete Dashnor Çarçani, i pajisur me license profesionale.

Nga ana e administratorit te kesaj shoqerie, z.Flamur Salija është bere kerkese përpara Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane për depozitimimin e ketij vendimi te asamblese se ortakeve te shoqerise prane zyres se Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si dhe per te pasqyruar ndryshimet perkatese edhe ne skeden e kesaj shoqerie.

Kjo kerkese eshte e drejte dhe bazuar ne ligj dhe, si e tille, duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses se administratorit te Shoqerise Tregtare "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k. per depozitim e Vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie te dates 15.06.2007, sipas te cilit është vendosur:

- I. Ndryshimi i selise se Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k., e cila nga adresa e vjeter: Unaza e Re, Godina Astir, do te jete ne adresen: **Qafa e Kasharit, tek mbikalimi i Rinasit.**
- II. Te rritet kapitali i shoqerise sipas raportit qe do te jape eksperti kontabel.
- III. Emerimin e ekspertit qe do te percaktoje sasine e rritjes se kapitalit dhe do te pergatise raportin perkates. Ne cilesine e ekspertit do te jete Dashnor Çarçani, i pajisur me license profesionale.


Depozitim e kerkeses dhe dokumentacionit te paraqitur nga Shoqeria "UNIVERS REKLAMA" Sh.p.k., duke bere shenimet perkatese ne Regjistrin Tregtar.

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te reflektoje keto ndryshime ne kolonat perkatese te skedes se shoqerise prane Regjistrit Tregtar.

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar t'u komunikojë vendimin personave te interesuar.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Majmala Rago', is written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.



## AKT THEMELIMI



### NENI 1

1. FLAMUR SALIJA i biri i Zelul dhe i Meme , dtl 16.07.1972 , banues ne Tirane Unaza e Re godina Astir , madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ka vendosur qe shoqeria e tij te marre formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare"

### NENI 2

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e statutit qe i bashkengjitet kesaj kontrate.

### NENI 3

Emri i shoqerise eshte " **UNIVERS REKLAMA** " SHPK.

### NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete  
Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte :  
Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice, te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektoral, ushqimor,elektroshtepiake.Prodhim, tregtim dhe eksport te reklamave . Transport mallrash .

### NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Tirane Unaza e Re godina Astir .

### NENI 6

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke .

### NENI 7

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

### NENI 8

Administrator i shoqerise eshte ortakut I vetem, FLAMUR SALIJA .

ORTAKU I VETEM

*Flamur Salija*

# STATUT



## I SHOQERISE " UNIVERS REKLAMA " SHPK

KRIJIMI FORMA, EMERTIMI , OBJEKTI  
SELIA, DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " UNIVERS REKLAMA " SHPK, me qender ne Tirane Unaza e Re godina Astir , krijuar sipas aktit te themelimit qe i bashkengjitet ketij statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga:

1. FLAMUR SALIJA i biri i Zelul dhe i Meme , dtl 16.07.1972 , banues ne Tirane Unaza e Re godina Astir , ka vendosur qe shoqeria e tij te marre formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare"

### NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine tregtare ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e ketij statuti.  
Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit ne gjykate.

### NENI 3

- Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte :  
Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice, te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektoral, ushqimor,elektroshtepiake.Prodhim, tregtim dhe eksport te reklamave . Transport mallrash .

### NENI 4

Emertimi i shoqerise eshte: " *UNIVERS REKLAMA* " SHPK.

### NENI 5

Qendra e shoqerise eshte ne Tirane Unaza e Re godina Astir ajo mund te hape filiale ne te gjitha rrethet e vendit ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Shoqeria e ka seline ne Tirane Unaza e Re godina Astir .  
Shoqeria ka vulen e vet me emrine e saj.



NENI 6

Kohezgjatja e shoqerise eshte e percaktuar per nje periudhe kohe mbi 10 vjet duke filluar nga dita e regjistrimit te saj. Kjo periudhe mund te shkurtohet ne rast se shoqeria priset para kohe.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI  
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 LEKE .

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi i Ortakut te Vetem.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore midis bashkeshortesh dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete me miratimin e ortakut te vetem.

NENI 11

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmone duhet te vertetohet me akt noterial

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI,  
KOMPETENCA, DHE KONTROLLI I SHOQERISE.

NENI 12

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Ortaku i Vetem

NENI 13

**Shoqeria administrohet nga ortaku i vetem FLAMUR SALIJA .**  
Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet kompetencave qe i jane percaktuar ne kete statut. Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratim te Ortakut te Vetem. Emerimi i tij behet per 3 vjet financiar, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit per paaftesi. Edhe drejtuesi teknik emerohet dhe shkarkohet me miratim te ortakut te vetem.

NENI 14

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit ,ndaj shoqërisë apo të tretëve , për shkelje të ligjeve, të dispozitave të këtij statuti apo për fajë gjatë administrimit të shoqërisë.

#### NENI 15

Disa nga kompetencat që i jepen administratorit janë:

- Të sigurojë drejtimin e mirë të shoqërisë
- Të administrojë pasurinë e shoqërisë
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët
- Të përfaqësojë shoqërinë para organeve gjyqësore ose autorizojë persona të tjerë kompetentë

-Kryen veprime juridike në emer dhe për llogaritë të shoqërisë me të tretët si: lidh kontrata, e, kryen veprime të ndryshme bankare brenda limitit që i lejon Ortaku i Vetëm.

#### NENI 16

Kontrolli i shoqërisë bëhet nga një ekspert kontabel i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i Vetëm

### IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE

#### NENI 17

Cdo vit financiar fillon me datë 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përfundimisht viti i parë financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

#### NENI 18

Llogaritë vjetore , inventari raporti mbi veprimtarinë e vitit financiar të hartuara nga administratori eksperti kontabel i autorizuar miratohet nga Ortaku i Vetëm.

#### NENI 19

Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë nxirret brenda 31 marsit të vitit pasardhës

#### NENI 20

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë mbasi zbriten të gjithë shpenzimet e kryera , Ortaku i Vetëm vendos për qellimin e përdorimit si: për investim, nxitjen ekonomike, reklame tregtare etj.

#### NENI 21

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit lirish të fitimeve dhe të disponimit lirish të pasurisë së saj në përputhje me qellimin e objektit të veprimtarisë që kryen.

#### NENI 22

Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë ajo i mbulon nga fondet rezervë ose nga shumatat suplementare.



NENI 23

Shoqëria gezon te gjitha te drejtat dhe mbrojtjen e pasurise se saj nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

V PUNESIMET NE SHOQERI

NENI 24

Per punonjesit qe do te punesohen marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen nepermjet kontrates se punes ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 25

Shoqëria merr persiper te derdhe rregullisht te gjithë detyrimet, gjithashtu dhe per kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

VI PRISHJA E SHOQERISE LIKUJDIMI.

Shoqëria prishet para kohe kur :

- Aktiviteti ekonomik i saj per disa vjet radhasi eshte me humbje.
- Per arsye te parashikuara ne ligj
- Ne cdo rast jeter me vendim te ortakut te vetem

NENI 27

Shoqëria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e marrjes se vendimit per prishjen e saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaku i vetem emerone nje ose dy likujdator te cilet i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise.

VII. KUSHTET E TJERA

NENI 28

Te gjitha vendimet e Ortakut te vetem rregjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahet ne seline e shoqerise.

NENI 29

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtrise se shoqerise dhe qe nuk zgjidhen me mirekuptim , organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE .

NENI 30

Ky statut eshte hartuar ne qytetin e Tiranës sot date: 07.07.2004

PER SHOQERINE "UNIVERS REKLAMA " SHPK

*Ortaku i vetem.*  
*Flamur Solaja*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE

Nr 906 rep



VERTETIM

Ne Tirane, sot date 04-04.2004 ne zyren e noterise Tirane, perpara meje noter u paraqit personi i quajtur Elmur Salija madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, me identitetin e te cilit u garanto va me leternjoftimin QH nr 073 891 i cili nenshkroi me vullnet te lire dhe te plote kete statut te shpk " UNIVERS REKLAMA " dhe une noteri vertetoj sipas ligjit nenshkrimin e tij

NOTER

RESHAT LESKAJ



SHOQERIA "UNIVERS REKLAMA" Sh.P.K.  
Me seli ne Unazen e Re godina Astir  
T I R A N E

Vendimi Nr.1 date 29 Qershor 2005



### ORTAKUT TE VETEM

Sot, me date 29 Qershor 2005 (dymije e pese), ne seline e Shoqerise « UNIVERS REKLAMA » shpk, ortaku i vetem i shoqerise Z.Flamur Salija , ka venundosur sa vijon :

Shoqeria „UNIVERS REKLAMA“ shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin E Gjykates Shkalles Pare Tirane Nr.31891 date 08.07.2004, me ortak te vetem dhe administrator Z.Flamur Salija, me kapital fillestar ne shumen 100.000 leke, me seli ne unazen e re godina „ASTIR“, me kohe zgjatje 10 vjet, me objekt : Import, eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektorak, ushqimor, elektroshtepijak. Prodhim, tregetim dhe eksport te reklamave. Transport mallrash.

Duke marre ne analize kerkesat e ligjit Nr.7667, date 28 Janar 1993, si dhe duke patur parasysh nenet perkatese te statutit te shoqerise, ortaku i shoqerise Z. Flamur Salija,duke qene pronar i 100% te kuotave te shoqerise :

#### V E N D O S I :

- 1) T'i shese Beqir Nuredinit 50% te kuotave dhe te kapitalit te shoqerise "UNIVERS REKLAMA" Sh.P.K.
- 2) Administrator i shoqerise do te jete Flamur Salija.
- 3) Ortaku Beqir Nuredini do te fitoje te drejtat dhe detyrimet ne momentin qe do te nenshkruhet kontrata perfundimtare e shitjes. Te gjitha detyrimet qe ka shoqeria perpara dates se nenshkrimet te kontrates shitjes kuotave jane ne ngarkim te shitesit Flamur Salija.
- 4) Depozitim prane Zyres se Regjistrimit Tregtar, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per te pasqyruar ndryshimet perkatese ne Statut dhe ne kolonen e regjistrimit tregtar.

Sa me siper ky vendim dhe keto dokumenta do te depozitohen prane Zyres se Rregjistrimit Tregtar.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Z.Flamur SALIJA

*Flamur Salija*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 5221 Rep.

Nr. 835 Kol.

### V E R T E T I M

Sot ne daten 29.06.2005 (dymije e pese), u paraqiten personalisht para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne Bulevardin " Zog I", ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, Z.Flamur SALIJA, me identitetin e pershkruar me siper,madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, i cili nenshkroi rregullisht dokumentin e mesiperm te perpiluar jashte kesaj zyre dhe une e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**NOTERE**

**RUKO SAKO**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 5288 rep.

Nr. 844 Kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH  
Neni 23 i ligjit 7632 date 4.11.1992

Sot ne daten 30 Qershor 2005 (dymije e pese), u paraqiten personalisht para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne Bulevardin " Zog I" ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, palet kontraktuese si vijon :

SHITESI : Z.Flamur SALIJA, i biri i Zelulit , lindur me 16.07.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga e Durresit tek ish shkolla e Partise, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i çertifikates se regjistrimit ne organin tatimor me Niptin Nr. K 41926003 N.

BLERESI : Z.Beqir NUREDINI, i biri i Xheladinit, lindur me 29 Qershor 1984 ne Rogozhine dhe banues ne Tirane, Rruga " Myslym Shyri", Pallati Nr.5, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. 1617670.

Te dy palet me kerkuan redaktimin e kontrates shitjes kuotave qe vijon:

Shoqeria „UNIVERS REKLAMA“ shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin E Gjykates Shkalles Pare Tirane Nr.31891 date 08.07.2004, me ortak te vetem dhe administrator Z.Flamur Salija, me kapital fillestar ne shumen 100.000 leke, me seli ne unazen e re Godina „ASTIR“, me kohe zgjatje 10 vjet, me objekt : Import, eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektorak, ushqimor, elektroshtepijak. Prodhim, tregetim dhe eksport te reklamave. Transport mallrash.

Ortaku i Vetem i Shoqerise Z.Flamur Salija deklaroi me deshiren e tij te lire e te plote se i shet bleresit Z.Beqir Nuredini 50% te kuotave dhe te kapitalit te shoqerise, i cili deklaroi se eshte dakord qe t'i bleje ato.

Me marreveshje te perbashket te dy palet kane percaktuar se çmimi per shitjen e 50% te kuotave eshte 50.000 ( pesedhjet mije) leke, shume e cila eshte likujduar totalisht nga bleresi Beqir Nuredini jashte zyres noterise.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale, shitesi Flamur Salija e humbet çdo te drejte ne 50% te kuotave dhe te kapitalit ne shoqerine "UNIVERS REKLAMA ,, dhe si shitesi edhe bleresi Beqir Nuredini behen bashkepronare, duke patur sejcili prej tyre nga 50% te kuotave dhe te kapitalit te Shoqerise „UNIVERS REKLAMA“ Sh.P.K.

Shitja e kuotave dhe kapitalit eshte e aprovuar ne mbledhjen e ortakut te Vetem Nr.1 date 29 Qershor 2005.

Kopjes se kontrates qe do te qendroje ne Zyren e Noteris ne Tirane i bashkangjitet fotokopja e vendimit Nr.31891 date 08.07.2004 i Gjykates Shkalles Pare Tirane.

Sa me sipër përfitohet nga une noterja kjo kontrate shitje kuotash, e cila ju lexohet paleve me ze dhe mbasi gjendet konforme vullnetit te tyre te lire e te plote e firmosin rregullisht ate, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITES

Z.Flamur SALIJA

*Flamur Salija*

BLERES

Z.Beqir NUREDINI

*Beqir Nuredini*

NOTERE  
RUKO SAKO


*[Signature]*

*[Signature]*

PULLE TAKSE



SHOQERIA "UNIVERS REKLAMA" shpk  
Selia: Unaza e Re, Godina ASTIR  
- Tirane -



**V E N D I M**  
**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**"UNIVERS REKLAMA" SHPK**

Sot, me date 15 Qershor 2007 (dymije e shtate), ne Seline e Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" shpk Tirane, Ortaket e Shoqerise Flamur Salija dhe Beqir Nuredini, te cilet kane nga 50% te kuotave te kapitalit themeltar sejcili mbidhen per te diskutuar mbi kete:

**REND DITE:**

1. Ndryshimin e selise se Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" shpk nga adresa e vjeter ne Unaza e Re, Godina Astir, ne adresen "QAFJA E KASHARIT – TEK MBIKALIMI I RINASIT".
2. Te rritet kapitali i shoqerise sipas raportit qe do te jape eksperti kontabel.
3. Emerimin e ekspertit qe do te percaktoje sasine e rritjes se kapitalit dhe do te pergatise raportin perkates. Ne cilesine e ekspertit do te jete Dashnor Çarçani, i pajisur me Liçensen Profesionale bashkelidhur dokumentacionit te Gjykates.


Reflektimin e ketij ndryshimi ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.  
Ortaket e shoqerise pasi diskutojne mbi rendin e dites,

**VENDOSIN:**

1. Ndryshimin e selise se Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" shpk nga adresa e vjeter ne Unaza e Re, Godina Astir, ne adresen "QAFJA E KASHARIT – TEK MBIKALIMI I RINASIT".
2. Te rritet kapitali i shoqerise sipas raportit qe do te jape eksperti kontabel.
3. Emerimin e ekspertit qe do te percaktoje sasine e rritjes se kapitalit dhe do te pergatise raportin perkates. Ne cilesine e ekspertit do te jete Dashnor Çarçani, i pajisur me Liçensen Profesionale bashkelidhur dokumentacionit te Gjykates.
4. Te ngarkoje Avokatin e Dhomes Kombetare te Avokates Av. Altin HAXHINASTO, me numer liçense 2766, te ndjeke te gjitha procedurat qe lidhen me depozitimin e ketij vendimi te Ortakut te Vetem ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, duke i dhene te drejten te depozitoje prane Gjyqtarit te vetem ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane çfaredolloj dokumenti, kerkese etj. si dhe te terheqe nga kjo gjykate vendimin e Gjyqtarit te Vetem.

**ORTAKET**

  
Z. Flamur SALIJA

  
Z. Beqir NUREDINI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

No. 2921 Rep.

No. 625/1 Kol.



**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot, me date 15 Qershor 2007 (dymije e shtate), u paraqit personalisht para meje, Notere Edlira HYSENI, me seli ne Tirane, Bulevardi Zogu I, Pallati 12 katesh, kati i dyte, ortaket e Shoqerise "Univers Reklama" shpk,

**Z. Flamur SALIJA**, i biri i Zelulit, lindur me 16.07.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga e Durresit tek ish shkolla e Partise, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Z1022795


**Z. Beqir NUREDINI**, i biri i Xheladinit, lindur me 29 Qershor 1984 ne Rogozhine dhe banues ne Tirane, Rruga " Myslym Shyri", Pallati Nr.5, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. 1617670.

Te cilet kane nenshkuar ne prezencen time Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" shpk, ndersa une noteria vertetoj nenshkrimin e tyre ne perputhje me ligjin.

NOTERE  
Edlira HYSENI



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL  
TE AUTORIZUAR TË SHQIPËRISE



(I E K A)  
L I C E N S E

Kjo license i teshohet, Z. DASHNOR BUREM CARCANI

per te ushtruar profesionin e EKSPERTIT KONTABELTE AUTORIZUAR.

Kjo License teshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit  
te E. K. A. dhe mban numrin: 122, sipas kësaj liste.

SEKRETARI

(JORGJI BOLLANO)

*Jorgji Bollano*

Leshuar me, 10.01.2001

PRESIDENTI

(BAKI BERBERI)

*Bakir Berberi*



20 GIU. 2007  
KERKESË

Z. M. Dajpe  
dt. 20.06.2007



**KERKUES:** Z. Flamur SALIJA, i biri i Zelulit, lindur me 16.07.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga e Durresit tek ish shkolla e Partise, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Z1022795, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise « Univers Reklama » shpk.

**OBJEKTI I KERKESES:** Depozitim prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Vendimit te Asamblese se Ortakëve te Shoqerise "Univers Reklama" shpk, date 15.06.2007.

**BAZA LIGJORE:** Ligji 7632, date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te Kodit tregtar" dhe Ligjin 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrimin Tregtar dhe Formalitetet qe duhen Respektuar nga Shoqerite Tregtare"

**DREJTUAR:**

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR  
(ZYRES SE REGJISTRIT TREGTAR)  
SEKSIONIT TREGTAR

TIRANE

Shoqeria "UNIVERS REKLAMA" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31891, date 08.07.2004, ndryshuar me vendimin nr. 31891/1, date 17.10.2005

Ortake te Shoqerise jane: Flamur Salija dhe Beqir Nuredini, te cilet kane nga 50% te kuotave te kapitalit themeltar sejcili.

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, adresa : Unaza e Re, Godina Astir.

Shoqeria me vendimin e saj te asamblese date 15.06.2007 ka vendosur ndryshimin e Selise se Shoqerise si dhe Emerimin e Ekspertit Kontabel Dashnor Çarçani per shfimin e kapitalit te Shoqerise.

Gjithashtu ka vendosur t'i beje kerkese Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per reflektimin e ndryshimeve ne skeden e shoqerise dhe depozitim e vendimit te Ortakut te Vetem.

KERKUES

Flamur Salija  
Z. Flamur SALIJA  
Administrator

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

No. 2122 Rep.

No. — Kok



**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot, me date 15.06. 2007 (dymije e shtate), u paraqit personalisht para meje, Notere Edlira Sako HYSENI, me seli ne Tirane, Bulevardi Zogu I, Pallati 12 katesh, kati i dyte, ortaku i Vetem i Shoqerise "Univers Reklama" shpk,

**Z. Flamur SALIJA**, i biri i Zelulit, lindur me 16.07.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga e Durresit tek ish shkolla e Partise, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Z1022795, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise « Univers Reklama » shpk,

i cili nenshkroi ne prezencen time kerkesen bashkelidhur ketij vertetimi nenshkrimi, drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

dhe une noteria vertetoj nenshkrimin e tij ne perputhje me ligjin.

NOTERE  
Edlira HYSENI







zj. B. Musa  
elt. 08.03.2007

08 MAR. 2007



KËRKESË

31891/2

**Kërkuesi :**

Z. Flamur SALIJA, i biri i Zelulit , lindur me 16.07.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga e Durresit tek ish shkolla e Partise, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i çertifikates se regjistrimit ne organin tatimor me Niptin Nr. K 41926003 N, Administrator i Shoqerise "UNIVERS REKLAMA" shpk.

**Objekti :**

Ndreqje Gabimi ne vendimin e Gjyqtarit te Vetem n. 31891/.

**Baza Ligjore :**

Neni 17, Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

*6.1.01.2007*  
*15.03.07*

**PER KOMPETENCE**

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**

**TIRANE**

**SEKSIONIT TREGTAR**

Shoqeria "UNIVERS REKLAMA" shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31891, date 08.07.2004.

Ne Vendimin e Ortakut te Vetem te shoqerise te dates 29 qershor 2005, paraqitur kesaj Gjykate , Shoqeria ka kerkuar shitjen e 50% te kuotave te shoqerise.  
Ne vendimin e Gjyqtarit te Vetem te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne paragrafin e dyte te dispozitivit te vendimit eshte shenuar emri Nuredin Bushi kur ne te vertete emri i sakte i ortakut tjetër te shoqerise eshte Beqir NUREDINI.

Per kete arsye duke u bazuar ne nenin 17 te ligjit 7667, date 28.0.1993, kerkoj nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë te behet ndreqja e gabimit ne emertimin e njerit prej ortakeve te shoqerise nga Nuredin Bushi ne **BEQIR NUREDINI**.

**KËRKUES**  
**Z. Flamur SALIJA**

*Flamur Salija*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE


Nr. 621 Rep.

Nr. — Kol.

V E R T E T I M

Sot ne daten 5 mars 2007(dymije e shtate), u paraqit personalisht para meje, notere Edlira Sako HYSENI, me adrese ne Bulevardin " Zog I", ne katin e dyte te pallatit 12 katesh,

Z. Flamur SALIJA, i biri i Zelulit , lindur me 16.07.1972 dhe banues ne Tirane, Rruga e Duresit tek ish shkolla e Partise, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, i cili nenshkroi rregullisht dokumentin e mesiperm te perpiluar jashte kesaj zyre dhe une e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.



NOTERE

EDLIRA HYSENI

318P/11

Blanca Muges  
10. 10. 2005



**K E R K E S E**

**E**

**SHOQERISE "UNIVERS REKLAMA" sh.p.k.**

E perfaqesuar nga Administratori dhe ortaku i vetem Z.Flamur SALIJA

OBJEKTI I KERKESES : Regjistrimin e vendimit te Ortakut te Vetem Nr.1 date 29.06.2005 per shitjen 50% te kuotave dhe te kapitalit te shoqerise.

**DREJTUAR GJYKATES SHKALLES PARE**

*Beqir Nuredin - 10 het kerkesa*

**TIRANE**

*dat 17.10.05*

**REGJISTRIT TREGTAR**

Shoqeria „UNIVERS REKLAMA“ shpk eshte regjistruar si person juridik me vendimin E Gjykates Shkalles Pare Tirane Nr.31891 date 08.07.2004, me ortak te vetem dhe administrator Z.Flamur Salija, me kapital fillestar ne shumen 100.000 leke, me seli ne unazen e re godina „ASTIR“, me kohe zgjatje 10 vjet, me objekt : Import, eksport dhe tregetim me shumice dhe pakete te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, blektorak, ushqimor, elektroshtepijak. Prodhim, tregetim dhe eksport te reklamave. Transport mallrash.

*Prodhim Nr.1 dat 29.6.05  
Ortakut Vetem  
Kant nati Shitje Nr  
5288/844  
dat 30.06.05*

Me vendimin Nr.1 date 29.06.2005 te Ortakut te Vetem te Shoqerise eshte vendosur :

- 1) T'i shese Beqir Nuredinit 50% te kuotave dhe te kapitalit te shoqerise "UNIVERS REKLAMA" Sh.P.K.
- 2) Administrator i shoqerise do te jete Flamur Salija.
- 3) Ortaku Beqir Nuredini do te fitoje te drejtat dhe detyrimet ne momentin qe do te nenshkruhet kontrata perfundimtare e shitjes. Te gjitha detyrimet qe ka shoqeria perpara dates se nenshkrimet te kontrates shitjes kuotave jane ne ngarkim te shitesit Flamur Salija.
- 4) Depozitimin prane Zyres se Regjistrimit Tregtar, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per te pasqyruar ndryshimet perkatese ne Statut dhe ne kolonen e regjistrimit tregtar.

Mendoj se kerkesa i ploteson te gjitha kushtet qe te shqyrtohet nga ana juaj dhe perfundimisht te vendoset si me siper.

**K E R K U E S I**  
Z.Flamur SALIJA  
*Flamur Salija*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 5287 Rep.

Nr. 843 Kol.

### V E R T E T I M

Sot ne daten 30.06.2005 (dymije e pese), u paraqiten personalisht para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne Bulevardin " Zog I", ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, Z.Flamur SALIJA, me identitetin e pershkruar me siper, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht nga une noterja, i cili nenshkroi rregullisht dokumentin e mesiperm te perpiluar jashte kesaj zyre dhe une e vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**NOTERE**

**RUKO SAKO**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE  
NR 905 REGJ.




### V E R T E T I M

Ne Tirane sot date 07.07.2004 , ne zyren e noterise , perpara meje noter u paraqit personalisht Flamur Salija madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me leternjoftim nr QH 073 891 i cili nenshkroi me vullnet te lire dhe te plote kete akt themelimi te shoqerise " UNIVERS REKLAMA " SHPK dhe une noterja vertetoj sipas ligjit 7928 date 01.06.1994 " Per Noterine " nenshkrimin e Tij .

NOTERE  
*Rehat Leska*  
*[Signature]*

31891

A. Ceca  
08 07 2004  


KERKESE

**KERKUES** : FLAMUR SALIJA i biri i Zelul dhe i Meme , dtl 16.07.1972 , banues ne  
Tirane Unaza e Re godina Astir .

**Me objekt** : Regjistrimin si Person Juridik te shoqerise me Pergjegjersi te  
kufizuar "UNIVERS REKLAMA " SHPK .  
Baza ligjore ligji nr 7667 date 28.01.1993 dhe ligji nr 7638 date  
19.11.1992

**PERPARA** : GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

Tirane

- Flamur Salija ka themeluar shoqerine me pergjegjersi te kufizuar  
"UNIVERS REKLAMA " shpk.


- Emri i shoqerise "UNIVERS REKLAMA " SHPK
- Ortak i kesaj shoqerie eshte Flamur Salija .
- Administrator i shoqerise eshte ortaku I vetem FLAMUR SALIJA .
- Kohezgjatja e shoqerise eshte 10 vjet.
- Selia e shoqerise eshte ne Tirane Unaza e Re godina Astir .
- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.
- Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte :

Import eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice, te artikujve te ndryshem  
industrial, bujqesor, blektoral, ushqimor,elektroshtepiake.Prodhim, tregtim dhe  
eksport te reklamave . Transport mallrash .

Kerkoj te merret ne shqyrtim kerkesa dhe ne perfundim te vendoset sipas objektit  
te saj.

  
Kerkues






REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE  
NR 904 REGJ.

### VERTETIM

Ne Tirane sot date 07.07.2004 , ne zyren e noterise , perpara meje noter u paraqit personalisht Flamur Salija madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me leternjoftim nr QH 073 891 i cili nenshkroi me vullnet te lire dhe te plote kete KERKESE te shoqerise " UNIVERS REKLAMA " SHPK dhe une noterja vertetoj sipas ligjit 7928 date 01.06.1994 " Per Noterine " nenshkrimin e Tij .




NOTERE  
*Rehat Leska*  
*Temp*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE

Nr. 909 Rregj.

V E R I F I K U M

Ne Tirane, shtet me dt.07.07.2004 (dymije e kater) para meje Note-  
rit Reshat LESKAJ, me seli ne Bulev. "BYCurri" u paraqit personalish  
Z.FLAMUR ZEFER SALIJA, i datlindjes 16.07.1972, banues ne Tirane  
Unaze e Re, godina ASTER, madhor, me zotesi te plofa juridike per te  
vepruar, me Leter Njoftimi QHNr.073 sl i cili depozitoj ne kete zyrtar  
100.000 (njegind mije ) leke shume kjo qe do te sherbej si KAPITAL  
Themeltar per shoqerine "UNIVERS REKLAMA" shpk.



NOTERI  
Reshat Leska  
*[Signature]*